



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”” (*Komisioni për dhënie mendimi*)

2. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar" (*Komisioni për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Rrahman Rraja, Lefter Koka, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Pjerin Shoshi - Drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Edlira Llango - Drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Bujqësisë

Elma Vathi - Shefe e Sektorit të Integritetit në Ministrinë e Bujqësisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Brenda kësaj jave kemi parashikuar disa mbledhje. Sot në rendin e ditës kemi dy çështje.

Çështja e parë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale”.

Të ftuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë: Pjerin Shoshi, drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë Sigurisë, Ushqimore dhe Zhvillimit Rural. Edlira Llango, drejtoreshë Juridike, dhe Elma Vathi, shefe e Sektorit të Integritetit.

Ju uroj mirëseardhjen në komision!

Pa humbur kohë u jap fjalën përfaqësuesve të ministrisë, të cilët mund të na shpjegojnë se ku konsiston kjo marrëveshje dhe pastaj kalojmë te pyetjet nga kolegët. A jeni dakord me rendin e ditës? Dakord.

Fjala për ju!

Pjerin Shoshi –Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Ju falënderoj për mikpritjen!

Marrëveshja me KfW-në dhe qeverinë federale të Gjermanisë konsiston në një fond prej 5 milionë eurosh, të cilat do të destinohen për kredi të buta që do t’u jepen ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që duan të investojnë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Cili është konteksti i kësaj marrëveshjeje?

Nga viti 2015-2017 ka pasur një fond garancie me KfW-në me një vlerë prej 3,5 milionë eurosh, i cili ka qenë shumë i suksesshëm, sepse fondet e disbursuara kanë arritur deri në 90%, të cilat janë disbursuar nëpërmjet bankave tregtare dhe institucioneve të mikrokredisë, të cilat sot operojnë në territorin e Shqipërisë.

Një arsye tjetër e kësaj marrëveshjeje është fakti, sepse ka pasur dy marrëveshje të mëparshme për asistencën ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat do të operonin në fushën e energjisë së rinovueshme, marrëveshje të cilat kanë kaluar në parlament, janë aprovuar, por që fatkeqësisht nuk kanë arritur të realizohen në terren, sepse niveli i disbursimit ka qenë shumë i ulët dhe, për këtë arsye, pas negociatave me KfW-në Ministria e

Bujqësisë ka menduar që këto fonde t'i alokojë në sektorin e bujqësisë dhe më së shumti në zhvillimin e zonave rurale. Dy marrëveshjet e mëparshme, për SME-të në përgjithësi dhe për SME-të që shkojnë e investojnë në fushën e energjisë së rinovueshme janë denoncuar me ministritë respektive. Pra, ato dy marrëveshje aktualisht kanë rënë dhe jemi në kushtet kur fondi prej 5 milionë eurosh është alokuar, të paktën në parim, për ndihmesën e ndërmarrjeve me karakter bujqësor dhe për zhvillimin e zonave rurale.

Një gjë dua të theksoj, nëse kjo marrëveshje nuk aprovohet brenda datës 31 dhjetor 2018, këto fonde, të cilat janë alokuar nga qeveria federale e Gjermanisë për qeverinë shqiptare do të digjen dhe do të humbasin.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Bitri!

Robert Bitri – Ju bëni një term të përgjithshëm kur thoni “në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”. Unë dua të di fushat në të cilat këto do të jepen.

Pjerin Shoshi – Zhvillimi i aktivitetit bujqësor, pra prodhimi bujqësor, agropërpunimi, agroindustria, diversifikimi i ekonomisë në zonat rurale, ku përmendim aktivitete të tjera, të cilat ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, por kemi listën e kredive, të cilat janë dhënë nga programi i mëparshëm nga viti 2015-2017, nga fondi i ngjashëm me vlerë prej 3,5 milionë eurosh, i cili është zbatuar përsëri me asistencën e KfW-së.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pasur vetëm në zonat malore apo fushore, nuk ka ndarje gjeografike. Pra të gjithë subjektet, qoftë fizikë, qoftë juridikë, janë të lirë të aplikojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'jua vëmë në dispozicion.

Eduard Shalsi – A mund ta sqarosh më mirë këtë pjesën e përfituesve të viteve 2015-2017?

Pjerin Shoshi – Atëherë, marrëveshja e mëparshme e KfW-së ka qenë me disa banka tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë, ku subjektet, fizike ose juridike, aplikojnë pranë bankave për kredi, të cilat janë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit të bizneseve në zonat rurale, më pas, si të gjitha procedurat e tjera të kredisë, konsultohet dhe vlerësohen nga bankat, gjithashtu vlerësohet edhe nga bordi drejtues i fondit në fjalë.

Sigurisht, arsyeja pse vihet në jetë ky fond është fakti që ulet niveli i kolateralit për aplikuesit dhe norma e interesit për aplikuesit. Pra, janë kredi më të favorshme.

Në raportin që do t'ju vëmë në dispozicion ka shifra ekzakte, por në informacionin që unë kam, Banka Tregtare e ka, të paktën, 2,5% më pak në institucionet e mikrokredisë dhe 1% në institucionet bankare normale.

Eduard Shalsi – Ndërkohë, ju thatë që po bëni rialokim.

Pjerin Shoshi – Është bërë rialokimi, sepse kanë rënë dy marrëveshje të mëparshme me Ministrinë e Ekonomisë dhe me Ministrinë e Mjedisit, vlera e të cilave ka kapur edhe Energjetikën, të cilat kapnin vlerën prej 5 milionë eurosh. Nga bisedimet që pala shqiptare dhe KfW-ja kanë pasur, këto fonde janë alokuar në fondin për të cilin po flasim.

Eduard Shalsi – Ne duhet të sigurohemi që pas një farë kohe të mos vijmë në parlament për ta ridiskutuar prapë këtë. Domethënë, nuk duam të dështojë ky fond dhe që kjo të mos ndodhë, ne duam të sigurohemi për mekanizmin.

Ju përmendet sipërmarrjet e vogla dhe të mesme. A dihen klientët potencialë, a ka një targetgrup? Dua të di mënyrën sesi do të informohen dhe mënyrën sesi do të komunikohen, sepse ne kemi portofola, të cilët janë ende të papërdorur, sidomos në fushën e bujqësisë. I gjithë buxheti që kemi alokuar vitin e kaluar, sot është ezauruar 50%, 40% dhe 60%. Pra, duam të sigurohemi që ky 5 milionësh do të bëhet efektiv për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Prandaj ne duam të dimë targetgrupin, cilat janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që mund të përfitojnë, si do të komunikohet me këto ndërmarrje dhe cilat janë problematikat që bankat transmetojnë, që do të thotë se çfarë ka qenë diçka që nuk ka shkuar, objektivi gabim, interesi, kolaterali apo ndërmarrjet.

Pjerin Shoshi – Së pari, subjektet që aplikojnë, të cilat regjistrohen në QKL dhe në QKB, janë ato subjekte që objektiv të tyre kanë zhvillimin e operativitetit në fushën e bujqësisë apo në zonat rurale. Siç e thashë edhe më parë, nuk ka një ndarje gjeografike të përcaktuar, që do të thotë se i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë është i lirë për të aplikuar. Mënyrën sesi do të informohen për mundësinë e aplikimit, këtë promovim e bëjnë bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e mikrokredisë. Vetëm pak kohë më parë ministri i Bujqësisë ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi, sidomos në fushën e skemave të subvencionit, ku një pjesë e mirë e subvencioneve që japim ne, sidomos në fushën e investimeve, duhet të mbulohen me të paktën 50% të kapitalit nga vetë investitorët. Kemi arritur një marrëveshje bashkëpunimi me bankat kryesore që operojnë në territorin e Shqipërisë, të cilat mund të krijojnë lehtësira. Me skemën kombëtare të vitit 2018, 50% e financon qeveria e Shqipërisë dhe 50 % duhet të financohet nga vetë investitorët.

Në skemën IPARD II, i cili do të lancohet nga data 30 nëntor, vlera e mbulimit nga ky program është 65% dhe pjesën e mbetur do ta vendos vetë...

Eduard Shalsi – Çfarë lidhje ka ajo me këtë?

Pjerin Shoshi – Ka lidhje, sepse një nga vështirësitë që ne kemi hasur në skemën e vitit 2018, duke qenë se u futën masa për investimin, ishte problemi se shumë nga fermerët nuk kishin kapital dhe likuiditetin e mjaftueshëm për të vënë në jetë investimin e tyre, sepse një nga kushtet për të përfituar 50% apo 60% është që investimi duhet realizuar 100% dhe, kur të jetë certifikuar realizimi 100% i investimit, ashtu siç është parashikuar në kontratë, vetëm në atë moment investitori mund të marrë pjesën e bashkëfinancimit nga shteti. Kjo i vendos subjektet apo bizneset, sidomos ato të vogla dhe të mesme, në vështirësi, sepse thonë që nuk kanë kapitalin e nevojshëm. Ky është problemi i këtij programi dhe BERZH-it.

Eduard Shalsi – Pra, ndryshe nga skema që keni parashikuar në vitin 2018, ku duhet ta bëjnë të gjithë investimin përpara dhe pastaj të përfitonin nga skema, me këtë skemë ju dilni në konkluzionin që do ta bëjmë 50 me 50.

Pjerin Shoshi - 50 me 50 ka qenë edhe në vitin 2018. Ky program është masë lehtësuese që investorët potencialë, përthithësit potencialë të parave nga skema kombëtare shtetërore të sigurojnë likuiditetin e mjaftueshëm në kushtet favorizuese nga bankat. Për shembull, nëse sot aktualisht norma e interesit në bankat tregtare është 5,5%, ata mund ta marrin me 4,5%. Nëse kolaterali i kërkuar është 180%, ata mund ta marrin me 100% dhe kjo është një lehtësi e vazhdueshme që fermerët të aksesojnë në portofolin e kredisë bankare, duke qenë se nuk ka një sektor.

Eduard Shalsi – Pse e solle analogjinë me skemat e 2018-ës?

Pjerin Shoshi – Sepse nga vlerësimet tona vumë re se një nga problemet që patën aplikuesit, të cilët nuk patën një numër të lartë aplikimesh në skemat e investimit, ishte problemi i vazhdueshëm, ku ata thoshin që duhet të realizojmë 100% të investimit, pastaj të marrim 50% të kapitalit mbrapsht nga shteti dhe nuk kemi para në dispozicion.

Eduard Shalsi – Me këtë marrëveshje ndryshon skema. Pra, nuk do të bëjnë investime 100%, por do të kenë lehtësi në kolateralin e interesit.

Pjerin Shoshi- Është një lehtësi që u jepet fermerëve dhe agrobizneseve për të marrë kredi me kushte lehtësuese, ndryshe nga kushtet që ka aktualisht tregu shqiptar.

Robert Bitri – Sa do të jetë saktësisht përqindja e kredisë që do të jepet, sepse ti thua 1% poshtë asaj që jep fondi. Fondi Besa sot jep edhe me 24% dhe 1% më pak shkon 23%. 23% do të thotë të vdesësh bujkun apo fermerin.

Pejrin Shoshi – Zoti deputet, ne do t'ju paraqesim raportin e programit që është zhvilluar dhe është implementuar gjatë periudhës 2015-2017, por norma e interesit nuk është në dorë të Ministrisë së Bujqësisë për ta vendosur, sepse janë bankat ato që zbatojnë një logjikë tregu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, unë po shikoja shënimet dhe na duhet të bëjmë një analizë të detajuar të gjithë këtyre institucioneve, jo vetëm banka, të cilat kreditojnë sektorin e bujqësisë. Brenda ka interesa të çmendura dhe unë kam frikë dhe shumë pikëpyetje për mënyrën sesi merren ato kredi dhe sesi shlyhen ato kredi, çfarë normash merren dhe si mund të ndërhyjmë ne. Ndoshta mund të jetë një masë më efektive reduktimi i normave të interesit dhe kompensimi nga buxheti i shtetit i këtyre institucioneve, duke kalkuluar norma fitimi precize. Unë nuk e di se sa është sot portofoli i kredidhënies nga bankat, apo bankat në sektorin e bujqësisë. Thuhet që është 150 milionë euro, ndërkohë që ne kemi alokuar 20 milionë euro në vitin 2018, nga të cilat bujqit kanë përthithur, zoti Beqaj, 50%, 40%, apo 60%.

Ilir Beqaj – Shpresojmë në fund të vitit të jetë 50%.

Eduard Shalsi –Pra, duhet parë, duhet rishikuar dhe analizuar e gjithë kjo me shumë detaje.

Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Qeveria gjermane i jep qeverisë shqiptare për të ndihmuar fermerët. Në qoftë se ne kemi të gjitha këto institucione, të cilat merren me fermerë, drejtojnë fermerë, udhëzojnë fermerët dhe nuk orientojnë veten e tyre që bankat t'u krijojnë kushte të tilla që ne po jua japim si garanci dhe ju të jepni një përqindje shumë të ulët dhe kjo të garantohet.... Në qoftë se fermeri nuk është në gjendje që këto lekë t'i bëjë efektive, çfarë problemi ka?

Eduard Shalsi – Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Së pari, dua ta vlerësoj nismën dhe të theksoj që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në bujqësi mendoj se janë ofruesit kryesorë të vendeve të punës në këtë fushë. Kështu që kjo projekt marrëveshje duket me vlerë për të zhvilluar më tej bujqësinë dhe për të krijuar mundësi punësimi.

Ju thatë se do të na vini në dispozicion raportin 2015-2017. Unë dua të di nëse kjo skemë ka qenë e suksesshme dhe cili ka qenë impakti më i madh. Çfarë keni vënë re ju që kanë ndikuar pozitivisht në këto ndërmarrje që keni financuar deri tani dhe cila ka qenë

vështirësia më e madhe? A keni një bazë të dhënash të sakta për të gjitha ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bujqësore, të cilat do të jenë potencialisht ato që do të shfrytëzojnë këtë mundësi?

Lidhur me atë që tha kryetari, edhe nga përvoja e kontakteve me fermerë apo individë që merren me fushën e bujqësisë, kam vënë re që shpeshherë janë të painformuar dhe humbasin mundësinë, sepse nuk kanë informacion. Ju thatë që përgjegjësinë për të informuar fermerët apo ndërmarrjet në përgjithësi e ka banka, por unë mendoj se vetë Ministria e Bujqësisë duhet të ketë këtë përgjegjësi të informimit dhe të monitorimit sesi funksionon kjo marrëdhënie kreditimi midis bankave dhe fermerëve, sepse përndryshe nuk do të absorbohet e gjithë shuma dhe nuk do të përfitojnë ata që mund dhe duhet të përfitojnë, ose ngelën të përjashtuar një pjesë e këtyre ndërmarrjeve. Si do ta garantoni ju që të gjithë të jenë të informuar dhe të nxiten për të aplikuar në këtë skemë?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Marto.

Andrea Marto – Unë kam të njëjtin shqetësim me zonjën Gjermani. Si organizohet informimi? Sepse një nga çështjet më të mëdha që kemi ne është informimi i të interesuarit. Unë nuk shoh ndonjë fushatë serioze informimi nga ana e ministrisë. A keni menduar ta organizoni ndryshe këtë fushatë informimi?

Rakip Suli – Faleminderit, kryetar!

Ju prekët problemin e interesit, i cili varion në bazë të bankave. Unë dua të di saktësisht sa do të jetë interesi bankar për këto kredi, që përfitojnë këto subjekte?

Unë mendoj se personat që merren me bujqësi janë shtresa më e pambrojtur, por që nga ana tjetër, kjo është e vetmja fushë që zgjidh problemin e punësimit në Shqipëri.

Meqenëse e përmendi edhe kryetari, unë mendoj se te subvencioni, të cilët përfitojnë 50% nga kredia, kjo pikë duhet parë, sepse, po t'i ketë para, ai do të ndërtojë vetë. Nëse mungojnë këto para, si do ta bëjë investimin në këtë biznes? Mendoj se është një pikë shumë e rëndësishme për ta parë, për ta vlerësuar. Mendoj se ka ardhur momenti për ta rikthyer kokën në drejtim të mbështetjes së fermerëve në Shqipëri, sepse shohim një përkushtim të vetë fermerëve që kanë interes të jashtëzakonshëm, ku paralelisht edhe pjesa e vaditjes është zgjidhur në pjesën më të madhe të territorit. Dua të di sa do të jetë interesi i këtyre përfituesve të kësaj kredi.

Eduard Shalsi – Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Duke u bashkuar me shqetësimet e shokëve, kam një pyetje. Është e vërtetë që informimi është një element shumë i rëndësishëm, sepse, po nuk e diti, nuk ka se si

ta bëjë. Ky është një kusht i nevojshëm, por nuk është i mjaftueshëm. A i ka sot kapacitetet fermeri ynë që të plotësojë dokumentacionin pasi informohet për të realizuar marrjen e kësaj kredie. Ne tani ndodhemi përpara një mundësie shumë të madhe financimi. Zoti Shalsi e përmendi rastin e qeverisë, por nesër apo pasnesër janë të IPARD-it. Përvoja e vendeve të BE-së, që kanë një nivel të standard edhe më të lartë se tonin, tregon se nuk absorbohen këto fonde. A i ka paraprirë Ministria e Bujqësisë mundësinë që do të ofrojë nesër për të mundësuar që këta fermerë, të cilët do të marrin këto fonde, të realizojnë të gjitha ato kritere dhe kërkesa që kërkon procedura përkatëse për t'u ndihmuar financiarisht?

Eduard Shalsi – Zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit, kryetar!

Unë dua të shtroja në formë bisede, sepse nga përgjigjja e njërës pyetje, varet pyetja tjetër.

Eduard Shalsi – Atëherë, vazhdo me përgjigjet e pyetjeve të kolegëve, pastaj me zotin Beqaj do të vijojmë pak më ndryshe.

Pjerin Shoshi – Dua ta nis duke shpjeguar fillimisht se çfarë është një fond garancie, i cili do t'u japë përgjigje shumë prej pyetjeve që u ngritën nga të nderuarit, më pas do të flas me detaje për secilën pyetje.

Fondi i garancisë është një shumë që vendoset në dispozicion të bankave si garanci për mungesën e kthimit mbrapsht të kredive të dhëna ndaj një grupi interesi të caktuar. Pra, çfarë do të thotë ky fond garancie? Sektori i bujqësisë nuk është aspak atraktiv për bankat për të dhënë kredi për arsye se kolaterali që fermerët apo që agrobizneset vendosin është në vlerë shumë të ulët dhe rreziku që mbart një investim në bujqësi është shumë më i lartë se në industritë e tjera, siç mund të jetë industria e ndërtimit apo industria e shërbimit për faktin se, nëse është një stinë e keqe, fermerëve u humbet prodhimi. Arsyeja e këtij fondi garancie është fakti që kreditë në bujqësi për bankat i bën më atraktive për arsye se një pjesë e rrezikut të portofolit të humbur prej tyre subvencionohet nga ky fond prej 5 milionë eurosh.

Qeveria e Shqipërisë vë në dispozicion 5 milionë euro. Për periudhën në fjalë 5 milionë euro nuk është e thënë se do të disbursohen të gjitha, pra nuk do të shpenzohen të gjitha për faktin sepse kryerja me sukses i një fondi garancie nuk është domosdoshmërisht vetëm disbursimi i 5 milionë eurove në formë kredie, por fakti se sa prej tyre do të përdoren nga bankat për të paguar kreditë e këqija të portofolit të tyre.

Po i kthehem normës së interesit, që është edhe pika më delikate e kësaj bisede. Norma e interesit nuk vendoset nga qeveria e Shqipërisë. Norma e interesit vendoset nga bankat tregtare, duke njohur tregun, konkurrueshmërinë e tyre. Nuk mund t'u imponohemi

bankave tregtare për t'u thënë një normë interesi të caktuar, sepse ajo që kemi parë edhe nga fondi i garancisë me BERZH-in shumë nga institucionet e mikrokredisë, por edhe bankat tregtare largohen sapo ne fillojmë dhe u hapim temën e imponimit të normës së interesit, sepse ata thonë që nuk mund të japin kredi, duke humbur para, të cilat nuk janë interesante nga pikëpamja financiare.

Cila është besueshmëria jonë në këtë fond garancie? Fondi i garancisë tre vjetët e mëparshëm, në periudhën 2015-2017, i cili po replikohet sot me një portofol më të madh nuk është më 3,5 milionë euro, por 5 milionë euro, të cilat janë disbursuar në nivelin 90%.

A kemi ne një listë të aplikuesve potencialë? Ne gjatë gjithë kësaj kohe, duke filluar nga muaji prill deri në shtator 2018 kemi pasur takime intensive me shoqata fermerësh, me shoqata të agrobiznesit, të personave që duan të investojnë jo vetëm në bujqësinë reale, por edhe në zonat rurale, siç është diversifikimi i ekonomisë me agroturizëm dhe biznese të ngjashme. Kemi një listë të bizneseve potenciale, të cilat do të aplikojnë jo vetëm për kredi, por edhe në të dyja skemat e subvencioneve, siç është ajo kombëtare dhe ajo e IPARD-it.

Për sa i përket informimit, informimin kryesor duhet ta bëjnë bankat, sepse ato janë të interesuarat primare që këtë portofol që marrin ta disbursojnë.

E dyta, ne si ministri kemi ngritur agropikat, të cilat shërbejnë për informimin e fermerëve dhe agrobiznesit për ofertat që ka në bujqësi për të realizuar investimet.

Për sa i përket pyetjes që u ngrit me shumë të drejtë se si fermerët, dhe ka qenë një nga pyetjet që agrobizneset kanë ngritur më së shumti, fakti që duhet të realizohet 100% i investimit, më pas, në varësi të skemës, 50%-65% të fondeve merren mbrapsht, pra është një problem i ngritur me të drejtë. Arsyeja që është vënë kjo klauzolë, më së shumti nga skema e programit "IPARD 2", lidhet me faktin e mungesës së theksuar të besueshmërisë të fermerët, që atë kanë shkruar në letër si plan biznesi, do ta implementojnë dhe do ta zbatojnë ashtu siç është parashikuar. Pra, ne si ministri kemi nevojë të kemi sigurinë që ajo që ka thënë fermeri, pas një apo dy vjetësh kur të realizohet investimi, të jetë i realizuar njësoj siç ka qenë në letër dhe jo të fillojë e të thotë se gjatë rrugës më doli një problem apo një tjetër, sepse do ta kemi të pamundur më pas t'u themi fermerëve të na kthejnë paratë mbrapsht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një kontratë.

Rakip Suli – Domethënë, e ka një kontratë paraprake? Ky investitor e ka garancinë në këtë pjesë.

Pjerin Shoshi – Ka një kontratë të firmosur nga drejtori i Përgjithshëm i AZHBR-së, pra nuk është një premtim me fjalë, por është një kontratë ligjore.

Rakip Suli – Se ishte shumë e rëndësishme kjo pjesa e garancisë.

Faleminderit!

Pjerin Shoshi – Pyetja e fundit ishte për dosjen e aplikimit.

Shpenzimet e dosjes së aplikimit, të paktën në programin “IPARD 2”, për fermerin janë mbuluara, pra fermeri deri në 5 mijë euro të investimit mund ta kanalizojë për dosjen e aplikimit, që mund të bëhet nga një zyrë e specializuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë zyra të licencuara.

Ilir Beqaj – Neni 1 i marrëveshjes pak a shumë përcakton se për çfarë parashikohet të përdoren këto fonde dhe janë: përmirësimi i pozicionit të gruas në shoqëri, vetëndihmë në luftën kundër varfërisë, fond garancie për kredinë apo projekt në sektorin e infrastrukturës sociale ose mbrojtjes së mjedisit. Kështu e lexoj unë nenin 1 të marrëveshjes që na keni sjellë. Pra, nga neni 1 i marrëveshjes unë kuptoj se këto do të jenë 4 destinacionet e mundshme. Pastaj te pika 2 e nenit 1 thoni: “Mund ta zëvendësojmë edhe me projekte të tjera nëse qeveria bie dakord me qeverinë gjermane”. Pra, për çfarë vini në parlament atëherë? Thojeni vete që në fillim se do ta përdorni për këtë gjë, sepse pastaj nga kreditë rurale, të dalim te pozicioni i gruas, te vetëndihma në luftën kundër varfërisë, pastaj thoni se mund ta ndryshojmë. Dakord, shumë mirë. Më mirë të jetë vetëm pika dy. E vendosni vetë ju në qeveri. Ne si shumicë i japim qeverisë sonë, në qoftë se gjermanët e marrin te parlamenti i tyre, vazhdojmë kështu.

Pjerin Shoshi – Një pjesë e marrëveshjes është një format standard, i cili është vendosur nga Republika Federale e Gjermanisë.

Për sa i përket pjesës së ndihmës së grave apo të luftës kundër varfërisë, arsyeja pse insistohet kaq shumë në investimet në bujqësi është fakti se, së pari, të ardhurat për frymë në sektorin e bujqësisë në zonat rurale janë jashtë standardit të minimumit të jetesës për Republikën e Shqipërisë, pra janë të ardhura që për momentin po nxitin, sidomos moshën e re, të largohen nga zonat rurale dhe nga investimet në bujqësi. Pikërisht këto lloje kredish mundësojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, janë të ardhura të fermerëve, nga sektori primar, që është ai i bujqësisë, që nuk i lejojnë të kenë të ardhura të mjaftueshme për të realizuar një jetesë siç është ajo që realizohet nga sektorë të ndryshëm, siç është sektori i shërbimit, i industrisë. Janë studime të ndryshme...

Ilir Beqaj – Ai që është studimi më i plotë për nivelin e varfërisë në Shqipëri thotë tjetër gjë, nuk thotë këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk doja të thosha atë. Në qoftë se eksportet bujqësore vjet dhe sivjet rriten me 20%, kush i rrit këto eksportet bujqësore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, i rritin fermerët.

(Diskutime pa mikrofon)

Ne jetojmë në fshat. Kemi varfëri dhe varfëri ekstreme të thepisur. Në zonat urbane e ke më keq. Kordonët që janë krijuar në qytetet tona nga lëvizjet e brendshme migratore janë më keq se në fshat, se ata janë pa gjë. Kam përshtypjen, drejtor, se e ke konkluzion të pasaktë.

Pjerin Shoshi – Për një pjesë të mirë të bujqësisë shqiptare, ajo që përmendët, mjafton të shikojmë të dhënat e INSTAT-it: prodhimi bujqësor dhe eksportet shqiptare janë rritur shumë duke filluar nga viti 2013, kur deficitin ynë tregtar ishte 1 me 9 në fushën e prodhimeve bujqësore, kemi arritur në 1,3, por ende fermerët kanë probleme...

Ilir Beqaj – Të lutem, referoju saktësisht! Në vitin 2013 raporti import-eksport në bujqësi sipas INSTAT-it ka qenë 6,7 me 1 dhe sot e ke 3,6 me 1. Këto janë shifrat zyrtare, jo 9 dhe 3, por 6,7 dhe 3,6.

Pjerin Shoshi – Problemi kryesor që ne kemi ndeshur, sidomos në zonat malorë, ajo që thatë ju, i nderuar, është fakti se shumë nga fermerët kanë vështirësi në kalimin nga kultura, të cilat nuk gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme në kultura që gjenerojnë të ardhura më të mëdha, të cilat janë të orientuara drejt eksportit. Arsyeja pse ne nxitin investimet në sektorin e bujqësisë lidhet pikërisht me faktin që t'u japim mundësi disa fermerëve që me sipërfaqen e limituar vetëm prej 1,2 hektarësh, që është sipërfaqja mesatare e tokës në Republikën e Shqipërisë ata të sigurojnë një të ardhur të mjaftueshme, e cila do t'i bëjë të qëndrojnë në sektorin e bujqësisë dhe të mos vazhdojnë në sektorë të tjerë të ekonomisë. Kjo është arsyeja përse nxiten investimet në bujqësi. Kur thashë që nuk sigurohen të ardhurat minimale është fakti se janë kultura të vjetra, produkte të cilat nuk janë të kërkuara nga tregu apo çmimet për këto produkte janë shumë të ulëta, duke mos u garantuar të ardhura të mjaftueshme. Pikërisht në këto zona të defavorizuara këta fermerë mund të sigurojnë të ardhura mbase edhe duke kaluar në diversifikimin e ekonomisë. Gjithashtu, edhe në ato zona që njihen si pole të zhvillimit bujqësor mund ta nxitin edhe më tepër.

Ilir Beqaj – Kthehemi te fondi i garancisë së BERZH-it që e prekët. Sa është ai fond?

Pjerin Shoshi – Kontributi i Republikës së Shqipërisë duhej të ishte në nivelin 36 milionë euro, për momentin është në 14 milionë euro. I gjithë fondi duhej të gjeneronte një portofol prej 180 milionë eurosh kredi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rreth 30 muaj. Nga “system commite” i fundit që patëm me BERZH-in normat e interesit, sidomos për ato që ishin targeti ynë më interesant, janë ulur me 0,5% në krahasim me normat tregtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga 4,5% në 4%. Te këto institucione mikrokredia ka kaluar nga norma interesi 18%-19% që ata e japin zakonisht, me imponimin tonë dhe të BERZH-it, madje arsyeja pse institucioni NOA doli nga fondi i garancisë ishte që norma e interesit të mos ishte më e lartë se 16% në lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’jua vëmë në dispozicion me raportin që do t’ju sjellim.

Eglantina Gjermeni – Kam një pyetje lidhur me afatin. Për sa kohë do të realizohet kjo? Sa është e vlefshme? Fillon në momentin kur miratohet në parlament, por sa e ka afatin? Kur fillon dhe kur përfundon si afat kohor?

Pjerin Shoshi – Kohëzgjatja nuk është vendosur në marrëveshje, sepse është pjesë e specifikimeve të kontratës që KfW-ja do të nënshkruajë me bankat respektive.

Eglantina Gjermeni – Në të kaluarën e patët 3 vjet, pra 2015-2017, megjithëse shuma ishte më e vogël, kështu që besoj se këtë radhë do të ketë një afat kohor më të shtrirë, meqenëse bëhet fjalë për 5 milionë euro.

Pjerin Shoshi – Nuk është e thënë për faktin se bankat janë edhe më të specializuara në këtë lloj fondi. Pra, nga bisedat dhe nga negociimet që kemi pasur me specialistët e KfW-s dëshira dhe vullneti i tyre është që të vazhdohet me bankat që kanë bashkëpunuar në programin e mëparshëm. Pra, ekspertiza e tyre është edhe më rritur.

Eduard Shalsi – Përpara se të kalojmë në votim, kemi bërë një pyetje para disa javësh gjatë diskutimit të një marrëveshjeje tjetër që kemi pasur në parlament. Një nga kolegët ka shtruar pyetjen: nëse sipërfaqja e ujitur është shtuar konsiderueshëm gjatë këtyre viteve, cili ka qenë rezultati, pra me sa për qind e ka shtuar prodhimin? Në fakt, ne u befasuam, sepse konkluzioni ishte se, pavarësisht se sipërfaqja nën ujë kishte shkuar rreth 220-230 mijë hektarë, nuk kishim një rritje proporcionale, madje përkundrazi nuk kishim

rritje. Kështu që ne presim një përgjigje nga ai person që ishte te mbledhja. Thjesht po jua rikujtoj. Të lutem, do të kujtosh edhe Enean, edhe Festimin që nuk ka ardhur ende përgjigja që kërkoi një deputet. Pra, investimet masive në skemat e ujitjes çfarë pasojash kanë prodhuar? Është rritur apo nuk është rritur prodhimi? Po shoh që je drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural. Ky është një tregues goxha i rëndësishëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po u referohemi të dhënave që jep INSTAT-i, për shembull, apo institucione të tjera.

Dakord?

Pra, nëse ka diçka që nuk shkon, të shohim se ku çalon.

Shtojmë edhe një fond tjetër të garancisë.

Beqaj, tha 180 me 22 milionë?

Ilir Beqaj – Po.

Eduard Shalsi - Pse na duhet ky 5-milionëshi?

Për çfarë na duhet ky fond garancie shtesë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të alokonim gjë tjetër? Se ne e kemi 180-tshen.

Ilir Beqaj – Meqenëse e denoncuam në korrik, kjo vjen nga ky denoncim.

Eduard Shalsi – Nga eksperiencia juaj si ministre, nuk mund të ishte rinegociuar për diçka tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Dakord.

Atëherë, kalojmë te votimin në parim.

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju falënderoj!

Mos harro dy informacionet, për Festimin dhe atë tjetrin, për përgjigjen për rendimentin dhe sipërfaqen.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.10.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar" (*Komisioni për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Rrahman Rraja, Lefter Koka, Hekuran Hoxhalli, Gjetan Gjetani, Dritan Bici dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Eduard Shalsi - Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar””, nismë e një deputeti, që qëndruaka pezull, ndërkohë që ne kemi pritur...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Petrit Vasili.

Jemi informuar që ka një propozim konkret, të plotë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë pranë përfundimit dhe, që të mos mbajmë pezull një propozim dhe t’i japim drejtim, do t’ju ftoja ta rrëzonit këtë propozim.

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Do t’ia lëmë Komisionit të Ekonomisë të shprehet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është që në 2016-n dhe kam përshtypjen se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, kam përshtypjen se je prononcuar për atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rendin e ditës është diskutuar, zoti Beqaj. Ka qenë i ftuar edhe zoti Vasili në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Votojmë në parim.

Pro? Nuk ka. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Nuk miratohet në parim.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet neni 1.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Neni 4.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Neni 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi diskutuar këtë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet neni 5.

Votojmë në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet në tërësi.

Ju falënderoj!

MBYLLET MBLEDHJA